

Data 11.07.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, Spitali Korce” - Marrveshje kuader me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të percaktuara – me afat 1(nje) vjecar (12 muaj)”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (FPP)
90510000-5 Trajtimi dhe hedhja e mbeturinave**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit: *Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrveshjes kuader; 3,057,600* (tremilion e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH, ose **3,669,120** (tremilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet) leke me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korce, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1**;*
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas **Shtojcës 2**;*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9***
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë, objektin e prokurimit.

2.1.2 Operatori duhet të jetë i pajisur me **Lejë Mjedisore III.1.B**

2.2.3 Operatori duhet të jetë i pajisur me **Licensë III.2.B**, të licensuar nga Ministria e Mjedisit.

2.2.4 Operatori duhet të zotërojë certifikatë ISO 9001 :2015 ose ekuivalent mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizata ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit.

2.2.5 Operatori duhet të zotërojë certifikatë ISO 14001 :2015 ose ekuivalent mbi “*Sistemet e menaxhimit të ambientit*”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizata ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit.

2.2.6 Operatori duhet të zotërojë certifikatë ISO BS OHSAS 18001 :2007 ose ekuivalent mbi “*Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë*”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizata ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë kërkuar për të vërtetuar se operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi dhe bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, gërma a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit) 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit që konkuron. Për këto operatorë ekonomikë duket të dorëzojë vërtetim lëshuar nga Dega e tatimit Taksave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është **3,057,600** leke pa TVSH,
40% e 3,057,600 = 1,223,040 leke pa TVSH.

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2020-2021-2022) duhet të jetë jo më e vogël se **1,223,040** leke pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar *Ligji Nr . 9920, datë 19.5.2008 Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 Per tatimkin mbi te ardhurat si dhe Udhezimi Nr.5, datë 30.01.2006 Per Tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar pika 3.12 “Deklarimi tatimor dhe Llogaritja perfundimtare e detyrimit”.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit që konkurron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është **3,057,600** leke pa TVSH,
20% e 3,057,600 = 611,520 leke pa TVSH.

Pra vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, te jetë në një vlerë jo më të vogël se **611,520** leke pa TVSH.

2.3.2 Operatori duhet të ketë të punësuar pjesë të stafit të tij, minimumi një punonjës të trainuar nga kompania prodhuese për teknologjinë që përdoret për trajtimin e mbetjeve, i cili të jetë i pajisur me Leje Higjeno Sanitare për aktivitetin që kryen. Për këtë operatori duhet të paraqesë:

- Certifikatën e trainimit të punonjësit / punonjësve të trainuar.
- Lejën Higjeno Sanitare.
- Listë pagesën sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a, për periudhën Janar – Qershor 2023, të konfirmuar nga Dega e Tatim Taksave ku është regjistruar subjekti, në të cilën duhet të jenë edhe punonjësi/ punonjësit e trainuar për sa më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë të punësuar pjesë të stafit të tij, minimumi një punonjës të trainuar nga kompania prodhuese për teknologjinë që përdoret për trajtimin e mbetjeve, i cili të jetë i pajisur me Leje Higjeno Sanitare për aktivitetin që krye, është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Transporti i mbetjeve do të bëhet nga operatori me automjetet të posaçëm, duke respektuar standartin sipas **VKM 798.datë 29.09.2010** “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”

- **Shtojca 4)** “ Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”.

2.4.2 Operatori do të instalojë një frigorifer (banak frigoriferik) në ambientet e spitalit Korçë, me kapacitet 120 – 250 litra (*në funksion të frekuencës së tërheqjes së mbetjeve*), dhe temperaturë – 18⁰, për ruajtjen e mbetjeve të lëngëshme dhe të ngurta deri në momentin e transportit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit.

2.4.3 Operatori do të sigurojë ambalazhin përkatës sipas specifikimeve të caktuara në **VKM 789, datë 29.09.2010**, “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”

- **Kreu III)** “ Trajtimi i mbetjeve spitalore ”, **Pika 8.4)** në përputhje me **Shtojcën 2.A** “ Etiketa e Kontenierëve ”.
- Qeskat dhe kontenierët duhet të mbulohen nga sipërmarësi dhe duhet të jenë me një përdorim. Kontenieret, qeskat që përdoren për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore që trajtohen në hidroklatin e spitalit të sigurohen nga operatori fitues. Kontenierët duhet të jenë me kapacitet nga 5 L, 40 L dhe 60 L. Kontenierët dhe qeskat duhet të jenë me ngjyrë të verdhe dhe logon e firmës fituese. Të gjithë kontenierët që përdoren nga spitali duhet të merren nga firma dhe të bëhet dezinfektimi i tyre prej saj. Ambalazhi duhet të jetë sipas përcaktimeve të bëra në **VKM-në Nr.798, dt.29.09.2010** “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “*Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore*”.

- 2.4.4** Operatori duhet të sigurojë ambalazhin përkatës sipas specifikimeve të caktuara në **Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore**. Furnizimi me ambalazh (kontenitorë plastik me kapak dhe qese të verdhe me logon) do të bëhet sipas kërkesave të AK.
- 2.4.5** Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë *prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambjentin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor*, në bazë të **VKM-së Nr. 798**, datë **29.09.2010** dhe Udhëzuesit kombëtar *“Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”*.
- 2.4.6** Tërheqja e mbetjeve të rrezikshme do të bëhet me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, dhe jo me rrallë se një herë në **15 (pesëmbëdhjete)** ditë.
- 2.4.7** Mbetjet e mbledhura të kontenjerëve përkatës do të peshohen në prani të të dy palëve. Operatori dhe Përfaqësuesit e Spitalit Korçë, për çdo dorëzim mbetjesh për asgjësim, do të përpilojnë **“ Dokumentin e marrjes në dorëzim të mbetjeve të rrezikshme”**, të sigluar nga të dy palët, sipas **VKM 371, datë 11.06.2014**, *“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe dokumentimit të dorëzimit të tyre”*.
- 2.4.8** Me qëllim ndjekjen deri në fund të procesit të asgjësimit të mbetjeve, operatori fitues, përveç faturës tatimore, do të dorëzojë edhe evidenca vërtetuese për transportin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme në mënyrë që të provojë se operacionet për kryerjen e tyre janë bërë në përputhje me vendimet, standardet dhe rregulloret e aprovuara. Pra, përveç faturës zotëruesi dhe asgjësuesi i mbetjeve duhet të disponojë mënyrën e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, analizat e kampionëve të hirit që përfitohet nga trajtimi i mbetjeve, të kryera sipas kërkesave si dhe të dokumentojë se kjo mbetje e ngurtë është asgjësuar në përputhje me nenin **21** të ligjit nr. **9010**, datë **13.2.2003** *“Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”*.

Argumentimi; Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ...”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

I. Specifikimet Teknike/Termat E Referencës:

Përshkrimi i zbatimit të kërkesave në lidhje me to:

1. Mbetjet e rrezikshme spitalore do të asgjësohen në një impiant të pajisur me **Lejë Mjedisore III.1.B** dhe **Licensë III.2.B**, të licensuar nga Ministria e Mjedisit. Mbetjet e rrezikshme spitalore që do të asgjësohen janë; - **Mbetjet anatomike** (*pjesë të trupit të organeve, placenta dhe pjesë nga Laboratori Anatomio – Patologjik*), Kodi **18.01.02** dhe - sende të ndotura me gjak, serume dhe plazmë, mbetje izolimi nga pacientë me koeficient infektimi të lartë (Covid 19), mbetje të mjekimeve dhe vaksinave, mbetje, shtresa dhe

material të tjera të infektuara, Kodi **18 01 03**, të cilat do të asgjësohen sipas **VKM 789**, datë **29.09.2010**, “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”

- **Shtojca 3)** “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, **Pika 1)** “Incenerim” si dhe
 - **Shtojca 5)** “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”. Kjo metodë e mbështetur në udhëzimin kombëtar “*Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*” dhe sipas përcaktimeve të bëra në udhëzuesin kombëtar “*Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore*” seksioni **7.1**, tabela **1**.
2. Transporti i mbetjeve do të bëhet nga operatori me automjet të posaçëm, duke respektuar standartin sipas **VKM 798**, datë **29.09.2010** “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”
- **Shtojca 4)** “ Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”.
3. Operatori do të instalojë një frigorifer (banak frigoriferik) në ambientet e spitalit Korçë, me kapacitet 120 – 250 litra (*në funksion të frekuencës së tërheqjes së mbetjeve*), dhe temperaturë – 18⁰, për rruajtjen e mbetjeve të lëngëshme dhe të ngurta deri në momentin e transportit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit.
4. Operatori do të sigurojë ambalazhin përkatës sipas specifikimeve të caktuara në **VKM 789**, datë **29.09.2010**, “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”
- **Kreu III)** “ Trajtimi i mbetjeve spitalore ”, **Pika 8.4)** në përputhje me **Shtojcën 2.A** “ Etiketa e Kontenierëve ”.
 - Qeskat dhe kontenierët duhet të mbulohen nga sipermarësi dhe duhet të jenë me një përdorim. Kontenieret, qeskat që përdoren për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore që trajtohen në hidrokлавin e spitalit të sigurohen nga operatori fitues. Kontenierët duhet të jenë me kapacitet nga 5 L, 40 L dhe 60 L. Kontenierët dhe qeskat duhet të jenë me ngjyrë të verdhe dhe logon e firmës fituese. Të gjithë kontenierët që përdoren nga spitali duhet të merren nga firma dhe të bëhet dezinfektimi i tyre prej saj. Ambalazhi duhet të jetë sipas përcaktimeve të bëra në **VKM-në Nr.798**, dt.**29.09.2010** “*Për administrimin e mbetjeve spitalore*”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “*Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore*”.
 - Operatori duhet të sigurojë ambalazhin përkatës sipas specifikimeve të caktuara në **Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore**. Furnizimi me ambalazh (kontenitorë plastik me kapak dhe qese të verdhe me logon) do të bëhet sipas kërkesave të AK.
 - Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë *prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambjentin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor*, në bazë të **VKM-së Nr. 798**, datë **29.09.2010** dhe Udhëzuesit kombëtar “*Administrimi i Sigurtë i Mbetjeve Spitalore*”.
5. Tërheqja e mbetjeve të rrezikshme do të bëhet me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, dhe jo me rrallë se një herë në 15 (pesëmbëdhjete) ditë.
6. Mbetjet e mbledhura të kontenierëve përkatës do të peshohen në prani të të dy palëve. Operatori dhe Përfaqësuesit e Spitalit Korçë, për çdo dorëzim mbetjesh për asgjësim, do

të përpilojnë “ **Dokumentin e marrjes në dorëzim të mbetjeve të rrezikshme**”, të sigluar nga të dy palët, sipas **VKM 371, datë 11.06.2014**, “*Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe dokumentimit të dorëzimit të tyre*”.

7. Operatori duhet të ketë të punësuar pjesë të stafit të tij, minimumi një punonjës të trainuar nga kompania prodhuese për teknologjinë që përdoret për trajtimin e mbetjeve, i cili të jetë i pajisur me Leje Higjano Sanitare për aktivitetin që kryen. Për këtë operatori duhet të paraqesë:
 - Çertifikatën e trainimit të punonjësit / punonjësve të trainuar.
 - Lejen Higjano Sanitare.
 - Listë pagesën sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a, për periudhën Janar – Qershor 2023, të konfirmuar nga Dega e Tatim Taksave ku është regjistruar subjekti, në të cilën duhet të jenë edhe punonjësi/ punonjësit e trainuar për sa më sipër.
8. Operatori duhet të zotërojë çertifikatë ISO 9001 :2015 ose ekuivalent mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizata ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit.
9. Operatori duhet të zotërojë çertifikatë ISO 14001 :2015 ose ekuivalent mbi “*Sistemet e menaxhimit të ambientit*”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizata ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit.
10. Operatori duhet të zotërojë çertifikatë ISO BS OHSAS 18001 :2007 ose ekuivalent mbi “*Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë*”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizata ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të prokurimit.
11. Me qëllim ndjekjen deri në fund të procesit të asgjësimit të mbetjeve, operatori fitues, përveç faturës tatimore, do të dorëzojë edhe evidenca vërtetuese për transportin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme në mënyrë që të provojë se operacionet për kryerjen e tyre janë bërë në përputhje me vendimet, standardet dhe rregulloret e aprovuara. Pra, përveç faturës zotëruesi dhe asgjësuesi i mbetjeve duhet të disponojë mënyrën e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, analizat e kampionëve të hirit që përfitohet nga trajtimi i mbetjeve, të kryera sipas kërkesave si dhe të dokumentojë se kjo mbetje e ngurtë është asgjësuar në përputhje me nenin **21** të ligjit nr. **9010**, datë **13.2.2003** “*Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta*”.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mësipërme janë përcaktuar përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/a të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- **Argumentim:** Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore, Spitali Korce.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga nënshkrimi i MK.

Per sa i perket sherbimit qe do te kryhet, do te percaktohet rast pas rasti ne minikontratat qe do te lidhen, ne zbatim te marrveshjes kuader, sipas nevojave te AK.

Shërbimet	Përshkrimi	Vendi i ekzekutimit	Sasia
1	Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore	Spitali Korce	12 000 kg e ndare sipas zerave si me poshte
1.1	Kategoria 18.01.02 (Mbetje Anatomike)	Spitali Korce	1000 kg
1.2	Kategoria 18.01.03 (Mbetje Infektive)	Spitali Korce	11000 kg

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, Spitali Korçë.

Detyrat: Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, Spitali Korçë.

Percaktuar me hollesisht tek specifikimet teknike

Shpërndarja: 12 Muaj

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Korçë.

Njesia e Prokurimit

- | | | |
|------------|------------|----------------------------------|
| 1. Bledar | HOXHALLARI | anetar (Përgjegjes i prokurimit) |
| 2. Vasilil | TENEQEXHI | anetar (Specialist i fushes) |
| 3. Entela | MADHI | anetare |